

Laborator 6 – Vektorët (2/9 ushtrime për zgjidhje: 6-7 me nga 2 kërkesa)

1. Ekzekutim programesh me vektorë me numër të **pacaktuar** elementesh.
2. Ekzekutim programesh me vektorë me numër të **caktuar** elementesh.

Udhëzime:

1. Ushtrimet e mëposhtme do të shkruhen në editorin e gjuhës C, do të ruhen në një direktori, të kompilohen, të linkohen dhe të ekzekutohen sipas komandave të dhëna në ambientin e gjuhës C.
2. Përgjigjet për rezultatet duhet të shkruhen në fletoren e laboratorit.
 - a. Në fletore duhet të shkruhen vetëm programet që **nuk janë të zgjidhur**.

Programi 1: Tregoni se çfarë realizojnë programet e mëposhtme:

```
#include <stdio.h>
main()
{
  int i;
  char s[]="Provim";
  for (i=1;i<6;i++)
  {
    printf("\n%c",s[i]);
  }
}
```

Programi 2:

```
#include <stdio.h>
main()
{
  int i,p=6;
  char v[]="Suksese";
  for (i=p; i>=0;)
  {
    printf("%c",v[i]);
    i=i-2;
  }
}
```

Programi 3:

```
#include <stdio.h>
main()
{
  int i=10;
  for (; i<16;i++)
  if (i%2==0)
  printf("\n");
}
```

```

else
printf("%d", i);
}

```

Do-While - while do

Programi 4: Korrigjoni gabimet në kodet e mëposhtëm:

```

# <stdio.h>
main()
{
char sum = 1, int i=1
do
{
s= p * ++i;
}
while( i <= 8 ) && p<100;
printf("\n S = %d/n, s * 1.0f", s);
}

```

Programi 5:

```

//programi synon afishimin e shkronjave D-N dhe kodin përkatës ASCII
#include <stdio.h>
main()
{
Char i ,j;
Int c=14;
i=j=3;
while( ++i <= c )
{
int j = 1;
printf("\nNr1 = %c Nr2 = %d", 64+ i, c2);
} do;
}

```

Programi 6 - Të ndërtohen programet që realizojnë kontrollin, nëse një numër i dhënë gjendet në një vektor me numra të plotë me N - elemente duke përdorur:

a. Ciklin **For**

b. Ciklin **While**

Programi 7 - Të ndërtohet programi, i cili lexon një vektor me N elemente, numra reale, afishon elementet e barabartë me elementin e 5 të tij dhe gjen se sa raste të tillë ekzistojnë.

Programi 8: Jepet vektori $V[N]$. Të ndërtohet një program që krijon një vektor të ri $A[N] = 3*V[N]$.

```
#include <stdio.h>
#define N 4
main()
{
    int V[N]; int i; int A[N];
    for (i=0; i<N; i++)
    {
        printf("jepni vleren e elementin me index %d = ", i);
        scanf("%d", &V[i]);
    }
    for (i=0; i < N; i++)
    {
        A[i]=3*V[i];
    }
    printf("Elementet e vektorit A jane:\n");
    for (i=0; i < N; i++)
    {
        printf(" %d", A[i]);
    }
    printf("\n");
}
```

Programi 9: Në vektorin NOTAT[N] jepen notat e studentëve të një grupi në lëndën e informatikës. Të ndërtohet një program C që gjen se cila është nota më e lartë që ka marrë ky grup dhe sa të tilla janë.

```
#include <stdio.h>
main()
{
    int Nota[10]={4,5,6,7,8,6,7,8,8,7};
    int i, Nota_max, k_max;
    Nota_max=Nota[0];
    k_max=0;
    for (i=1; i < 10; i++)
    {
        if(Nota[i]>Nota_max)
            Nota_max=Nota[i];
    }
    for (i=0; i < 10; i++)
    {
        if(Nota[i]==Nota_max)
            k_max++;
    }
    printf("Nota maksimale %d \n", Nota_max);
    printf("Ne sasine %d \n", k_max); }
}
```